

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I
SPORTIT



Punim Master

TEMA:

**VLERËSIMI I NDRYSHIMEVE NË DISA TESTE MORFOLOGJIKE,
LËVIZORE-BAZIKE DHE SITUACIONALE TEK BASKETBOLLISTËT E RINJË**

Mentori:
Prof.Dr. Hazir Salihu

Kandidati:
Astrit Rexha

PRISHTINË, 2015

1. HYRJE

Basketbolli i ditëve të sotme, është bërë sport shumë kompleks dhe atraktiv, duke iu falënderuar zhvillimit të koncepteve sistematike nga ana e ekspertëve botëror. Përsosja e tyre është bazuar në imagjinatën si pjesë e të menduarit në krijimtarinë e basketbollit.

Në kuadër të kësaj, nëse përqendrohemi në zhvillimin e basketbollit bashkëkohorë, do të shohim se si gjithnjë e më shumë dominojnë përgatitjet fizike, shpejtësia e reaksionit dhe shpejtësia e aksioneve të sakta dhe precize, forca trupore, si dhe mbrojtjet agresive.

Në kuadër të kësaj që u cek më lartë ndër elementet bazike që e bëjnë lojën e basketbollit janë: bllokimet ose zëniet, de-bllokimet e shpejta në kohën e duhur, hapat e parë agresivë, eksplozivë, me top dhe pa top, qëndrimet e shpejta bazike, agresive në mbrojtje, shpërthimet para dhe pas bllokut. Po ashtu në basketbollin modern rendësi të madhe është duke iu kushtuar vendosjeve për faul në sulm që kërkon shpejtësi koncentrim dhe reagim në kohë dhe hapësirë, kontakti me bllok-out, ndërprerja e lëvizjeve të kundërshtarit dhe shkatërrimi (çrregullimi) i sulmeve si dhe ndërprerja e pasimeve dhe pranimeve të topit afër zonës, përmirësimi i teknikës së vendosjes në mbrojtje dhe sulm aftësia për kërcime të shpejta eksplozive në mbrojtje dhe sulm dhe në fund përmirësimi i shpejtë gjatë kalimit nga një fazë në fazën tjetër në lojë të basketbollit.

Në gjithë këtë ka ndikuar përmirësimi sistematik i rregullave të basketbollit dhe futja e risive të reja që ka ndikuar në rritjen e nivelit të lojës dinamike dhe atraksionet. Me një fjalë dëshira për këtë sport dhe nevoja për tu shoqëruar, ka përfituar çdo kënd në oazën e vogël të basketbollit.

Basketbolli si lojë sportive është i dashur, i adhuruar dhe i afërt për të gjithë sidomos për fëmijët dhe të rinjtë.

2. HULUMTIMET E DERITANISHME

Hulumtimet e bëra deri më tani për njohjen e karakteristikave morfologjike dhe motorike si dhe ndërlidhjet ndërmjet këtyre hapësirave, si dhe ndryshimet ndërmjet grupeve të ndryshme kanë qenë temë e shumë hulumtuesve në lëmin e basketbollit dhe të sporteve tjera.

Masar, N., (1982) në punimin “ Analiza kooperative e karakteristikave trupore dhe aftësive motorike të basketbollistëve të niveleve të ndryshme garuese”. Mostra e etniteteve kanë qenë tri ekipe të para të ligës së dytë të ish federatës së atëhershme dhe tri ekipet e para të ligës së parë të Kosovës në sezonin 1981 / 1982.

Masar, N., në vitin 1985, në disertacionin e doktoratës “Analiza e karakteristikave trupore dhe aftësive motorike të basketbollistëve të niveleve të ndryshme garuese dhe analiza komparative me volejbollistë dhe hendbollistë”, ku si mostër entitetesh ka marrë lojtarët të tri rangjeve, kurse mostra e ndryshoreve ka qenë 11 antropometri dhe 7 motorikë.

Hazir S., në vitin 2000, në punimin e Magjistraturës, ka testuar relacionet e disa karakteristikave trupore dhe aftësive motorike, bazike situacionale tek basketbollistët e moshës 14+ 6 muaj. Si model(mostër) e këtij punimi i cili përfshin 108 basketbollistë të rijnë të gjinisë mashkullore, të qytetit të Prishtinës, ku për model të ndryshoreve ka morfologjinë dhe ka aplikuar 10 teste, dhe aftësive motorike situacionale (5) teste, dhe (5) teste tjera nga aftësitë motorike të përgjithshme apo bazike.

Hazir, S., në vitin 2003, në disertacionin e Doktoraturës, me titull “Ndryshimet e zhvillimit të veçorive morfologjike dhe aftësive motorike të basketbollistët e rijnë” .Studimi ka përfshirë numrin e 161 basketbollistëve të moshës 16 vjeçar, dhe atë testimin fillestarë dhe përfundimtarë. Në hapësira morfologjike ka përfshirë (11) teste ndërsa në hapësirën motorike bazike dhe situacionale ka përfshirë 12 teste, nga testimi fillestarë dhe përfundimtarë. Nga hapësirat e testeve

morfologjike janë fituar tre faktorë, ndërsa tek hapësira e testeve motorike, bazike e situacionale, janë fituar 4 faktorë me rëndësi të vlefshme .

Faik, Ç., (1981), ka bërë hulumtime në hapësirën motorike në segmente të forcës, shpejtësisë dhe precizitetit. Këto hulumtime i ka realizuar me 118 sportistë aktivë (hendbollistë, basketbollistë dhe volejbollistë të ligës së Kosovës dhe të ligës së ish Federatës.

H. Rushiti :. Struktura faktoriale e dimensioneve morfologjike dhe relacioni i tyre me disa aftësi lëvizore tek të rinjtë e moshës 13 – 14 vjeç. Mostra e përbërë prej 205 nxënësve ka vërtetuar strukturën dhe relacionet e rëndësishme ndërmjet sistemit të variableve morfologjike (18) dhe atyre lëvizore (12) të fituar dy faktorë morfologjikë dhe tre faktorë lëvizorë. Punim i Magjistraturës në Prishtinë – 1999.

M. Gabrijeliç me 1977 ka hulumtuar, në mostrën prej 222 sportistëve kulminantë të rangut federativ, të moshës 18-25 vjeçare, anëtar të kategorisë së sporteve mashkullore, basketboll (54), futboll (52), volejboll (58), hendboll (58), lidhmëria e dimensioneve manifeste latente, të përgjithshme dhe specifike motorike, kognitive dhe konative me sukses në secilën lojë sportive posaçërisht, atë e ka bërë analizën komparative të lojërave sportive. Janë përdorur 16 teste universale në të gjitha grupet e të testuarve , dhe atë nga tre teste specifike situacionale për secilën lojë sportive . Aftësitë e basketbollistëve kulminant në krahasim me sportet tjera janë renditur si në vazhdim : Basketbollistët janë superior në forcën eksplozive të këmbëve dhe duarve, kurse më inferior në shpejtësinë e vrapimit. Përveç kësaj të gjitha dimensionet manifestuese të neurotizmit gjeneral të basketbollistëve janë më se pak të shprehura në raport me tri lojërat tjera sportive.

Z.Johan.: Në vitin 1991, ka bërë hulumtimin me mostër prej 124 entitete, të ndarë në grupe të caktuara, duke preferuar ndonjë sport e në mesin e tyre edhe basketbollin. Autori ka trajtuar 11 variabla morfologjike dhe 11 variabla motorike, gjatë përpunimit të rezultateve është aplikuar analiza kanonike – diskriminative. Grupi diskriminativ më i mirë ishte me testin kërcim së gjati nga vendi, dhe kërcimi tre hapësh nga vendi. Këta dy faktorë diskriminativ janë sinjifikant.

Fatmir, K., në vitin 1997, në temën e diplomës, “Vlerësimi i disa karakteristikave morfologjike dhe motorike të basketbollistët e ekipeve “ Trepça “ dhe “ Prishtina”. Hulumtimi ka përfshirë numrin e 24 basketbollistëve të moshës mbi 17 vjeçar. Në hapësira motorike bazike dhe situacionale ka përfshirë (7) teste ndërsa në hapësirën Morfologjike ka përfshirë 7 teste.

Fikret, Sh., në vitin 2006, në temën e magjistraturës “Ndryshimet e disa parametrave morfologjikë dhe testeve motorike bazike dhe situacionale ndërmjet basketbollistëve të superligës dhe ligës së parë të Kosovës”, arriti në përfundim se ka pasur mjaftë ndryshime ndërmjet dy ligave të basketbollit e gjithashtu edhe ndërmjet ekipeve brenda superligës dhe ligës së parë.

3. QËLLIMI I PUNIMIT

Duke u bazuar në numrin e basketbollistëve të rinj të cilët janë trajtuar në këtë punim moshë e tyre, tretmani i ndryshëm sistematik, më konkretisht të shkollave të basketbollit, me këtë edhe të numrit të ndryshoreve, objektivat kryesore në këtë projekt do të përkufizohen me realizimin e këtyre qëllimeve:

Vlerësimi i disa karakteristikave mbi nivelin morfologjik, aftësitë lëvizore bazike dhe specifike të këtyre grupmoshave të caktuara.

Vlerësimin e ndryshimeve në hapësirën morfologjike, lëvizore ndërmjet dy grupeve përkatëse të basketbollistëve të rinj.

Lidhmëritë ndërmjet ndryshoreve të hapësirës morfologjike, lëvizore dhe situacionale.

Parashikimi i ndryshoreve kriterike të cilat shprehin në një masë lojën e basketbollit në bazë të sistemit të ndryshoreve morfologjike, lëvizore dhe situacionale.

3.1 Hipotezat themelore

Më qëllim të vërtetimit të saktë dhe shkencorë të temës së parashtruar dhe objektivave primarë janë parashtruar këto hipoteza:

H1 - Pres të paraqiten ndryshime të rëndësishme ndërmjet ndryshoreve morfologjike dhe atyre lëvizore bazike ndërmjet dy grupeve.

H2 - Pres të ketë shpërndarje normale të shumica e ndryshoreve të trajtuara në këtë punim.

H3 - Pres të ketë ndikim të rëndësishëm të sistemit të ndryshoreve lëvizore në parashikimin e ndryshoreve kriterike.

4. METODOLOGJIA E PUNËS

4.1 Mostra e entiteteve

Në këtë projekt janë trajtuar basketbollistët e rinj të moshës 14-15 vjeç nga shkolla e basketbollit në Mitrovicë (30 basketbollistë) dhe shkolla e basketbollit në Prishtinë (30 basketbollistë). Numri i përgjithshëm është prej 60 basketbollistëve të gjinisë mashkullore të cilët ushtrojnë në dy shkolla të ndryshme të basketbollit.

4.2 Mostra e ndryshoreve të testeve

Mostra e të rinjve në këtë projekt i është nënshtruar procedurave të testimit në kushte të njëjta, para fillimit të orës stërvitore. Grupin e parë të ndryshoreve e përbëjnë ndryshoret morfologjike dhe testet e aftësive lëvizore të karakterit bazik, ndërkaq grupin e dytë e përbëjnë ndryshoret situacionale tipike të lojës së basketbollit.

Ndryshoret Morfologjike

	NDRYSHORET	SHIFRA
1	LARTËSIA E TRUPIT	LARTT
2	PESHA E TRUPIT	PESHA
3	GJATËSIA E KRAHUT	GJAKRA
4	GJATËSIA E KËMBËS	GJAKEM
5	GJATËSIA E PËLLËMBËS SË DORËS	GJAPELL
6	GJERËSIA E PËLLËMBËS SË DORËS	GJEPELL
7	GJATËSIA E SHPUTËS SË KËMBËS	GJASHP
8	GJERËSIA E SHPUTËS SË KËMBËS	GJESHP

Ndryshoret motorike bazike

	NDRYSHORET	SHIFRA
1	KËRCIM NË LARGËSI NGA VENDI	KGJAT
2	KËRCIM SË LARTI NGA VENDI	KLART
3	VRAPIM 20 M (STARTI I LARTË)	VR20M
4	HEDHJA E TOPIT BASKETBOLLIT NË LARGËSI NGA POZITA ULUR	HTGJU
5	TESTI I MUSKUJVE TË BARKUT (30 SEK.)	TMUSB

Ndryshoret motorike situacionale

	NDRYSHORET	SHIFRA
6	DRIBLIM VJATJE-ARDHJE 20M	UVA20
7	DRIBLIM NË FORMË ZIK-ZAKE 20M	UZZ20
8	GJUAJTJE E LIRË ME DORË TË DJATHTË	GJLDD
9	GJUAJTJE E LIRË ME DORË TË MAJTË	GJLDM
10	GJUAJTJE NGA GJYSMË DISTANCA 3M	GJGJD

4.3 Përshkrimi i instrumenteve matëse të përdorura

Për matjen e masave morfologjike janë përdorur instrumentet matëse morfologjike sipas Martinit.

- antropometri i Martinit, i cili na mundëson saktësinë e matjes prej 0,1cm,
- peshorja, e cila na mundëson saktësinë e matjes prej 0,1 kg,
- shiriti milimetrik matës.



Testet motorike janë vlerësuar me ndihmën e disa paisjeve të domosdoshme me të cilat është bërë matja:

- Kronometri mekanik elektronik,
- konat plastik,
- metri matës
- letër hameri,
- ngjitës i letrës,



4.4 Mënyra e zbatimit të procesit matës

Para startimit të procesit matës çdo subjekti i është dhënë verbalisht informatë për pikat matëse dhe nga ana e matësve është demonstruar pozita e qëndrimit gjatë matjes. Është treguar qëllimi i matjes, në mënyrë që mos të krijohet huti gjatë procesit matës dhe që subjektet të jenë sa më të lirë.

Matja e masave morfologjike është bërë prej orës 9.00 deri 11.00. Matjet i ka bërë grupi i studentëve të studimeve pasdiplomike të Fakultetit të Shkencave Sportive të cilët kanë pasur njohuri paraprake për teknikat e matjes.

Matja e parametrave antropometrik në hapësirën e cila ka qenë mjaftë e ndriçuar dhe në të cilën temperatura ka qenë në kufij të normales, prej 17 deri 22°C.

Instrumentet kanë qenë të standardizuara dhe të bazhdaruara para fillimit të matjes dhe gjatë matjes. Të ekzaminuarit kanë qenë këmbëzbathur, të veshur vetëm në brekë sportive.

Testet e ndryshoreve motorike janë kryer në sallat ku basketbollistët i kryejnë stërvitjet dhe garat e tyre.

Nga ana e basketbollistëve këto matje janë pritur me interesim të madh e sidomos testet e precizitetit, kërcimit dhe vrapimit 20m.

4.5 Përshkrimi i ndryshoreve matëse të punimit

4.5.1 Ndryshoret Morfologjike


LARTËSIA E TRUPIT - Lartësia e trupit është matur me antropometër. Me rastin e matjes, i eksperimentuari duhet të jetë i zbathur, në brekë dhe të qëndrojë në bazë të fortë horizontale. Koka duhet të ketë atë pozitë ku arrihet horizontalja e Frankfurtit (skaji i poshtëm i syrit dhe skaji i epërm i zgavrës së jashtme të veshit të jenë në pozitë horizontale). Qëndrimi i trupit duhet të jetë i drejtë, shputat e bashkuara. Eksperimentuesi qëndron në të majtë të të eksperimentuarit, pasi që kontrollon pozitën e tij dhe vendosjen e instrumentit, lëshon horizontalen e antropometrit deri në pjesën parietale të kokës. Rezultati lexohet me saktësi 0.1 cm.



PESHA E TRUPIT - Pesha e trupit është matur me peshoren me sustë e cila mundëson saktësinë e matjes prej 0.1 kg, treguesi rregullohet në pozitën zero. E domosdoshme është që peshorja të vëhet në pozitë horizontale. I eksperimentuari është i zbathur, në brekë të shkurtra, qëndron i qetë, në këmbë, në mes të peshores. Pasi që treguesi në peshore të qetësohet, rezultati lexohet me saktësi prej 0.1 kg.



GJATËSIA E KRAHUT - Gjatësia e krahut është matur me antropometër të shkurtuar. I eksperimentuari qëndron drejt, me dorë dhe shuplakë të shtrirë, lehtësisht të larguar nga trupi. Njëri skaj i antropometrit vendoset në majë të gishtit të mesëm të dorës së majtë, kurse tjetri skaj (aty ku lexohet rezultati) në zgjatimin shpatullor (processus acromialis) të anës së njejtë. Rezultati lexohet me saktësi 0.1 cm.




GJATËSIA E KËMBËS - Gjatësia e këmbës është matur me antropometër. I eksperimentuari duhet të qëndrojë sikurse në matjen e lartësisë së trupit. Matja bëhet nga dyshemeja ku qëndron i eksperimentuari deri në pikën e quajtur “gjembi i sipërm i përparmë i çapokut” (spina iliaca anterior superior) të anës së majtë, e cila caktohet me gishtin e mesëm të dorës që mban pjesën horizontale të antropometrit. Rezultati lexohet me saktësi 0.1 cm.




GJATËSIA E PËLLËMBËS SË DORËS-

Matet me kompas rrëshqitës. Gishtërinjtë shtrihen anash në amplitudë maksimale, kompas rrëshqitës vendoset në fallangjet e fundit të gishtit më të gjatë dhe në përfundim të shuplakës. Saktësia e matjes është 0.1 cm.

**GJERËSIA E PËLLËMBËS SË DORËS –**


Matet me kompas rrëshqitës. Gishtërinjtë shtrihen anash në amplitudë maksimale, kompas rrëshqitës vendoset në fallëngjet e fundit të gishtit të madhë dhe gishtit të vogël. Matet distanca ndërmjet gishtit të madh dhe gishtit të vogël Saktësia e matjes është 0.1 cm.



GJATËSIA E SHPUTËS SË KËMBËS – matet me antropometër të shkurtuar. I maturi qëndron ulur me këmbën e majtë të mbledhur që formon këndin e drejtë dhe me shputë vendosur në dysheme. Matësi ia vendosë krahët e antropometrit në thembër dhe në gishtin më të gjatë, (thonjtë duhet të jenë të prerë). Rezultati lexohet me saktësi prej 0.1cm.



GJERËSIA E SHPUTËS SË KËMBËS – Matet me kompas rrëshqitës. I maturi qëndron në pozitë të drejtë. Peshën e vetë e shpërndanë njëjtë në të dy këmbët, me shputa të vendosura paralel dhe për një gjerësi të shputës të ndara njëri nga tjetra. Matja bëhet nga lartë (ana dorzale). Krahët e kompasit vendosen në pjesën metatarzale në anën tibiale dhe mehertarza të anës fibuliare. Saktësia e matjes është 0.1 cm.



4.5.2 Ndryshoret Motorike

NDRYSHORJA**SHIFRA**

KËRCIM NË LARGËSI NGA VENDI

KGJAT

Me këtë test matim forcën eksplozive të muskujve.

Mjetet: Shkumësi, apo stilolapsat me ngjyrë, shiriti metalik në centimetra.

Shkëputja kryhet nga vendi me të dy këmbët. Janë të lejuara lëvizjet e hovit me duar, dhe ngritja në gishtërinj të këmbëve para shkëputjes. Shkëputja e dyfishtë nuk është e lejuar.

Detyrat: subjekti kërcen sa më lartë që mundet dhe rënien duhet ta bëjë me të dy këmbët. Ekzekutohen dy deri në tri kërcime.

Vlerësimi: gjatësia e kërcimit matet me distancën prej vijës së shtytjes e deri të gjurma më e afërt që e lenë pjesa e prapme e shputave, me rastin e rënies. Vlen rezultati i kërcimit më të gjatë i cili shënohet në centimetra.

Rezultati në fletë testin përkatës shënohet me saktësi 1 cm.



NDRYSHORJA	SHIFRA
3 KËRCIM SË LARTI NGA VENDI	KLART

Me këtë test matim forcën eksplozive të muskujve.

Mjetet: Shkumësi, apo stilolapsat me ngjyrë, shiriti metalik në centimetra.

Shkëputja kryhet nga vendi me të dy këmbët. Janë të lejuara lëvizjet e hovit me duar, dhe ngritja në gishtërinj të këmbëve para shkëputjes. Shkëputja e dyfishtë nuk është e lejuar.

Detyrat: subjekti kërcen sa më lartë që mundet me të dy këmbët dhe rënien duhet ta bëjë me të dy këmbët. Ekzekutohen dy deri në tri kërcime.

Vlerësimi: gjatësia e kërcimit matet nga distanca kur subjekti prekë pikën më të lartë me dorë (foto 1) deri tek distanca kur subjekti prekë me dorë pikën më të lartë të kërcimit në foton 2 e cila arrihet pas shkëputjes maksimale në pjesën e majeve të gishtërinjve .

Vlen rezultati i kërcimit më të gjatë i cili shënohet në centimetra.

Rezultati në fletë testin përkatës shënohet me saktësi 1 cm.



NDRYSHORJA	SHIFRA
1 VRAPIM 20 M (STARTI I LARTË)	VR20M

Me këtë test matim shpejtësinë bazike.

Mjetet: Kohë matës, (Kronometër), shiriti ngjitës, kona për shënimin e startit dhe cakut.

Detyra: Subjekti qëndron me të dy këmbët pas vijës së startit, në pozicionin starti i lartë. Matësi jep komandën “gati” (pas së cilës subjekti përkulet para, me peshën në këmbën e përparme) dhe “tani” pas së cilës subjekti fillon vrapimin dhe tenton që maksimalisht shpejtë të vrapojë në distancën 20 m.

Në momentin kur startuesi jep komandën “tani”, duke lëshuar dorën prej pozitës horizontale – poshtë, matësi i kohës e nisë matjen me kronometër dhe e ndalë atë kur subjekti e kalon me gjoks vijën e cakut.

Vlerësimi: matet koha prej startit deri te caku dhe rezultati i fituar shënohet në fletë testin përkatës me saktësi 0.10sec.



NDRYSHORJA**SHIFRA**

HEDHJA E TOPIT TË BASKETBOLLIT NË LARGËSI NGA POZITA

HTGJU

ULUR


Ky test matë forcën e krahëve dhe forcën eksplozive. Duke mbajtur kontakt me murin mund të testohet vetëm forca e krahëve.

Paisjet: Topi i basketbollit, shiriti matës, dysheku. Një mur për mbështetje dhe sipërfaqe jo e rrëshqitshme.

Subjekti mbështetet me shpinë të kthyer nga muri, ulet mbi dyshek me këmbë të larguara lehtësisht anash topi mbahet me duar anash dhe pak prapa qendrës së tij.

Topi tërhiqet afër gjoksit, pastaj hedhet fuqishëm para-jashtë sa më larg që është e mundur. Ekzekutohen tri tentime.

Këndi i hedhjes së topit është i rëndësishëm. Duhet të sqaroni te subjekti këndin optimal për të arritur distancën maksimale të hedhjes, dhe të mundësoni disa prova para hedhjes. Për të mundësuar matjen më të lehtë, mund të shtrini shiritin matës përgjatë trajektorës së hedhjes së topit.



Regjistrohet distanca prej murit deri ku hedhet topi. Matja regjistrohet në 5-10cm dhe merret rezultati i regjistruar i hedhjes më të mirë nga tri hedhjet e ekzekutuara.

Shpina duhet të ruaj kontaktin me murin gjatë gjithë kohës.

NDRYSHORJA	SHIFRA
TESTI I MUSKUJVE TË BARKUT (30 SEK.)	TMUSB

Qëllimi i testit ulem-lart është që të monitoroj zhvillimin e muskujve abdominal të subjektit.

Pajisjet: dyshek, një asistent që ti mbaj këmbët, kronometri sipërfaqe e rrafshët.

Shtrijuni në dyshek me gjunjë të mbledhur në këndin 90°, shputat vendosen rrafshët për dysheme, kurse duart pas koke si në figurën A., ndihmësi mund të mbaj shputat tuaja në dysheme.

Startoni çdo ulje në ndejë me shpinë në dyshek. Ngritni trupin deri në pozitën 90° dhe pastaj kthehuni në dyshek dhe prapë përsëritni lëvizjen. Testi përfundon kur kalon koha prej 30 sekondave.

Monitoron mënyrën e drejtë të ekzekutimit dhe bënë numërimin e përsëritjeve. Regjistroni numrin e uljeve lartë për 30 sekonda.



Ndryshoret motorike situacionale

NDRYSHORJA**SHIFRA**


DRIBLIM VJATJE-ARDHJE 20M UVA20

Me këtë test matim aftësitë anaerobe në gjatësi 20 metra “vajtje-ardhje”, në raport me kohën.

Mjetet: topi i basketbollit, pipi për sinjalizim dhe kohë matësi.

Detyra e subjektit është që duke udhëhequr topin të kalojë shtegun “vajtje-ardhje”, me shpejtësi maksimale, por pa i thyer rregullat e driblimit dhe hapave. Startohet nga vija fundore deri te koni i vendosur në 20 metra, pastaj gjatë kësaj kohe bëhet një kthim dhe prapë vazhdohet udhëheqja e topit për 20 metrat e ardhshme.

Rezultati vlerësohet me saktësi 0.01 sekonda.



NDRYSHORJA**SHIFRA**

DRIBLIM NË FORMË ZIK-ZAKE 20M UZZ20

Me këtë test matim shpejtësinë bazike, si dhe aftësitë individuale të sportistit në situata e kontrollit të topit në shpejtësinë maksimale.

Mjetet: Kohë matës, (Kronometër), kona.

Detyra: Subjekti qëndron me të dy këmbët pas vijës së startit, në pozicionin start i lartë. Matësi jep komandën “gati” (pas së cilës subjekti përkulet para, me peshën në këmbën e përparme) dhe “tani” pas së cilës subjekti fillon vrapimin dhe tenton që maksimalisht shpejtë të udhëheqë topin në distancën 20 m në mes pengesave.

Në momentin kur startusi jep komandën “tani”, duke lëshuar dorën prej pozitës horizontale–poshtë, matësi i kohës e nisë matjen me kronometër dhe e ndalë atë kur subjekti e kalon me gjoks vijën e cakut.

Vlerësimi: matet koha prej startit deri te caku dhe rezultati i fituar shënohet në fletë testin përkatës me saktësi 0.10 sec.



NDRYSHORJA**SHIFRA****GJUAJTJE E LIRË ME DORË TË DJATHTË GJLDD**

Me këtë test matim precizitetin e gjuajtjeve për një pikë me dorën e djathtë.

Mjetet: Top të basketbollit, një ndihmës, hapësira e gjuajtjeve të lira.

Detyrat: subjekti i cili ekzekuton gjuajtjet duhet të qëndroj në vijën e gjuajtjeve të lira. I testuari merr topin nga ndihmësi dhe fillon gjuajtjet një pas një. Basketbollisti kryen kështu gjashtë gjuajtje. Gjuajtjet duhet të egzekutohen sipas rregullës së gjuajtjeve të lira në lojën e basketbollit .

Kohë zgjatja e ekzekutimit të ushtrimit nuk është e kufizuar.

Vlerësimi: Numërohet shënimet e sakta nga pozita e cekur dhe rezultati i arritur shënohet në fletë testimin përkatës.



NDRYSHORJA**SHIFRA****GJUAJTJE E LIRË ME DORË TË MAJTË GJLDM**

Me këtë test matim precizitetin e gjuajtjeve për një pikë me dorën e majtë.

Mjetet: Top të basketbollit, një ndihmës, hapësira e gjuajtjeve të lira.

Detyrat: subjekti i cili ekzekuton gjuajtjet duhet të qëndroj në vijën e gjuajtjeve të lira. I testuari merr topin nga ndihmësi dhe fillon gjuajtjet e një pas njëshme. Basketbollisti kryen kështu gjashtë gjuajtje. Gjuajtjet duhet të gjuhen sipas rregullës së gjuajtjeve të lira në lojën e basketbollit.

Kohë zgjatja e ekzekutimit të ushtrimit nuk është e kufizuar.

Vlerësimi: Numërohet shënimet e sakta nga pozita e cekur dhe rezultati i arritur shënohet në fletë testimin përkatës.



NDRYSHORJA**SHIFRA**

GJUAJTJE NGA GJYSMË DISTANCA 3M GJGJD

Me këtë test matim precizitetin e gjuajtjeve nga gjysmë distanca prej 3 metrave me ndihmën e tabelës.

Mjetet: 2 topa të basketbollit, dy ndihmës.

Detyrat: subjekti i cili ekzekuton gjuajtjet duhet të qëndroj në gjysmë distancë pranon topin nga ndihmësi dhe fillon gjuajtjet nga gjysmë distanca me ndihmën e tabelës, pas gjuajtjes së parë lëvizë në pozitën 2. pranon topin nga ndihmësi dhe gjuan prapë me ndihmën e tabelës, pastaj prapë kthehet në pozitën paraprake dhe gjuan e kështu me radhë deri sa të ekzekutoj 6 gjuajtje.

Kohë zgjatja e ekzekutimit të ushtrimit nuk është e kufizuar.

Vlerësimi: Numërohen shënimet e sakta nga pozita e cekur dhe rezultati i arritur shënohet në fletë testimin përkatës.



4.6 Metodatat e përpunimit të rezultateve

Bazuar në qëllimin primar të punimit dhe hipotezave të parashtruara. Në këtë hulumtim do të aplikohet metoda e përpunimit të të dhënave të cilat do të mundësojnë sigurimin e **informatave** të mjaftuara për realizimin e qëllimit, duke shfrytëzuar programe adekuate për përpunimin e të dhënave.

- Mesi aritmetik - Mean
- Devijimi standard - Std.Dev.
- Gabimi i mesit aritmetik - St.Error
- Rezultati maksimal - Max
- Rezultati minimal - Min
- Simetria e distribucionit - Skew
- Kulmi i distribucionit - Kurt
- Distribucioni Max D - K-S p
- Korelacioni (Pearson), lidhmëria ndërmjet ndryshoreve.
- T-testi, dallimet ndërmjet dy ndryshoreve
- F-ratio, dallimet e variancës ndërmjet dy ndryshoreve
- Analiza regressive – për parashikimin e ndryshoreve kriterike në bazë të sistemit të ndryshoreve prediktore.

5. REZULTATET DHE DISKUTIMI

5.1 Parametrat themelor statistikor të ndryshoreve morfologjike, lëvizore bazike dhe situacionale

Tabela 1 – Parametrat themelor statistikor të ndryshoreve morfologjike, lëvizore bazike dhe situacionale të grupit të parë

	Mean	Min	Max	Std.Dev.	St.Error	Skew	Kurt	K-S p
LARTT	175.23	155.00	197.00	10.68	1.95	.16	-.64	p > .20
PESHA	62.03	43.00	79.40	9.12	1.66	.11	-.02	p > .20
GJAKRA	77.08	67.00	87.40	5.09	.93	.17	-.43	p > .20
GJAKEM	93.11	79.10	108.00	6.49	1.18	-.17	.18	p > .20
GJAPPELL	26.89	24.00	29.90	1.52	.28	.32	-.68	p > .20
GJEPELL	9.46	8.50	10.80	.59	.11	.26	-.57	p > .20
GJASHP	19.06	16.50	22.30	1.48	.27	.57	.11	p > .20
GJESH	8.14	7.40	9.10	.48	.09	.36	-.57	p > .20
KGJAT	201.00	160.00	240.00	23.33	4.26	-.14	-1.00	p > .20
KLART	39.97	30.00	55.00	6.97	1.27	.72	-.31	p > .20
VR20M	3.68	3.12	4.67	.34	.06	1.06	1.63	p > .20
HTGJU	8.71	5.15	11.20	1.58	.29	-.73	.07	p > .20
TMUSB	21.20	17.00	27.00	2.73	.50	.22	-.96	p > .20
UVA20	9.21	8.10	11.00	.75	.14	.56	-.28	p > .20
UZZ20	4.98	4.10	5.88	.50	.09	-.10	-.97	p > .20
GJLDD	2.77	1.00	5.00	1.28	.23	.36	-.78	p < .20
GJLDM	1.07	.00	3.00	1.11	.20	.67	-.89	p < .10
GJGJD	2.87	1.00	5.00	1.20	.22	.01	-.56	p < .15

Në tabelën 1 janë paraqitur parametrat statistikor të ndryshoreve morfologjike të grupit të parë. Lartësia trupore mesatare e grupit të parë është 175.23 cm, kurse pesha e trupit 62.03 kg.

Grupi i parë i basketbollistëve tek testi i vrapimit 20 metra e ka kaluar mesatarisht për 3.69 sekonda, ndërsa tek testi kërcim së gjati mesatarja arrin 2.01 metra.

Të gjitha ndryshoret e aplikuara në punim kanë shtrirje normale të rezultateve.

Tabela 2 – Parametrat themelor statistikor të ndryshoreve morfologjike, lëvizore bazike dhe situacionale të grupit të dytë

	Mean	Min	Max	Std.Dev.	St.Error	Skew	Kurt	K-S p
LARTT	176.70	157.00	193.00	9.64	1.76	-.13	-.88	p > .20
PESHA	64.99	45.40	90.30	11.83	2.16	.23	-.48	p > .20
GJAKRA	76.64	69.00	85.00	4.43	.81	.14	-.84	p > .20
GJAKEM	93.05	80.00	105.00	7.36	1.34	.01	-1.07	p > .20
GJAPELL	26.50	24.00	30.00	1.43	.26	.17	.24	p > .20
GJEPELL	9.40	8.00	10.60	.82	.15	-.38	-.96	p > .20
GJASHP	19.29	16.30	23.00	1.43	.26	.35	.78	p > .20
GJESHP	8.21	7.20	9.00	.47	.09	.03	-.35	p > .20
KGJAT	203.23	165.00	240.00	21.68	3.96	.03	-1.21	p > .20
KLART	39.83	27.00	50.00	6.16	1.13	-.24	-1.08	p < .20
VR20M	3.76	3.13	4.65	.41	.08	.58	-.28	p > .20
HTGJU	9.10	6.92	11.60	1.45	.26	.21	-1.13	p > .20
TMUSB	21.37	17.00	26.00	2.50	.46	.05	-.88	p > .20
UVA20	9.27	8.00	10.69	.75	.14	.06	-.81	p > .20
UZZ20	5.06	4.09	6.40	.54	.10	.46	.04	p > .20
GJLDD	2.43	1.00	5.00	1.04	.19	.19	-.20	p < .05
GJLDM	1.23	.00	3.00	1.07	.20	.58	-.84	p < .05
GJGJD	3.27	1.00	5.00	1.23	.22	-.19	-.64	p > .20

Tabela 2 paraqet rezultatet e ndryshoreve morfologjike, motorike bazike dhe atyre motorike situacionale dhe shpërndarjen e këtyre rezultateve.

Grupi i dytë i basketbollistëve ka lartësi trupore diç më të madhe se grupi i parë 176.70 centimetra e me këtë edhe peshë mesatare më të madhe 64.99 kg.

Shumica e ndryshoreve kanë shpërndarje normale të rezultateve, ndërsa përjashtim bëjnë gjuajtjet e lira me dorën e majtë dhe të djathtë ku është testuar saktësia e gjuajtjes. Këto dy ndryshore nuk kanë treguar shpërndarje normale të rezultateve brenda grupit.

Tabela 3 – Parametrat themelor statistikor të ndryshoreve morfologjike, lëvizore bazike dhe situacionale të dy grupeve



	Mean	Min	Max	Std.Dev.	St.Error	Skew	Kurt	K-S p
LARTT	175.97	155.00	197.00	10.11	1.31	.01	-.79	p > .20
PESHA	63.51	43.00	90.30	10.58	1.37	.30	-.17	p > .20
GJAKRA	76.86	67.00	87.40	4.73	.61	.17	-.57	p > .20
GJAKEM	93.08	79.10	108.00	6.88	.89	-.06	-.61	p > .20
GJAPPELL	26.70	24.00	30.00	1.48	.19	.26	-.28	p > .20
GJEPELL	9.43	8.00	10.80	.71	.09	-.25	-.61	p > .20
GJASHP	19.17	16.30	23.00	1.45	.19	.44	.24	p > .20
GJESHP	8.18	7.20	9.10	.47	.06	.19	-.57	p < .20
KGJAT	202.12	160.00	240.00	22.36	2.89	-.07	-1.06	p > .20
KLART	39.90	27.00	55.00	6.52	.84	.33	-.59	p > .20
VR20M	3.72	3.12	4.67	.38	.05	.79	.31	p < .20
HTGJU	8.90	5.15	11.60	1.51	.20	-.35	-.19	p > .20
TMUSB	21.28	17.00	27.00	2.60	.34	.13	-.95	p > .20
UVA20	9.24	8.00	11.00	.75	.10	.30	-.64	p > .20
UZZ20	5.02	4.09	6.40	.51	.07	.23	-.33	p > .20
GJLDD	2.60	1.00	5.00	1.17	.15	.38	-.43	p < .05
GJLDM	1.15	.00	3.00	1.09	.14	.59	-.90	p < .01
GJGJD	3.07	1.00	5.00	1.22	.16	-.07	-.68	p < .05



Parametrat statistikor të dy grupeve së bashku janë paraqitur në tabelën 3, ku është paraqitur edhe shpërndarja e ndryshoreve të këtij punimi.



Lartësia mesatare të të gjithë të testuarve është 175.97 centimetra ata peshojnë mesatarisht 63.51 kilogram, por në mesin e tyre ka subjekt të cilët kanë peshuar edhe 90.4 kilogram.



Vrapimin 20 metra ata e vrapojnë mesatarisht për 3.72 sekonda, ndërsa disa prej tyre mund të kërcejnë së gjati nga vendi edhe 240 centimetra.



Në tabelë shpërndarje jo normale është paraqitur vetëm të ndryshoret lëvizore situacionale tek gjuajtjet që tregojnë saktësinë në basketboll.



























5.2 Lidhmëritë ndërmjet ndryshoreve morfologjike, lëvizore bazike dhe situacionale

Tabela 4 - Lidhmëritë e ndryshoreve morfologjike të basketbollistëve

	LARTT	PESHA	GJAKRA	GJAKEM	GJAPPELL	GJEPELL	GJASHP	GJESHHP
LARTT	1.00							
PESHA	.51	1.00						
GJAKRA	.76	.55	1.00					
GJAKEM	.24	.14	.20	1.00				
GJAPPELL	.61	.46	.72	.11	1.00			
GJEPELL	.23	.42	.23	-.01	.38	1.00		
GJASHP	.50	.45	.60	.07	.74	.35	1.00	
GJESHHP	.33	.44	.38	-.06	.52	.40	.45	1.00

Në tabelën 4 janë paraqitur lidhmëritë e ndryshoreve morfologjike. Shumica e ndryshoreve morfologjike kanë realizuar lidhmëni statistikiisht të vlefshme.

Lidhmëria më e lartë është realizuar ndërmjet testit të gjatësisë së krahut dhe lartësisë së trupit. Gjatësia e këmbës nuk ka lidhmëri statistikiisht të vlefshme me masat e shputës së këmbës dhe pëllëmbës së dorës.

Masat e gjatësisë dhe gjerësisë së pëllëmbës së dorës kanë lidhmëri të vlefshme me ato të shputës së këmbës.

Sqarim:

Çdo vlerë korelative më e madhe se **.25** është statistikiisht e vlefshme në nivel të probabilitetit 0.05,

Tabela 5 - Lidhmëritë e ndryshoreve lëvizore bazike dhe situacionale të basketbollistëve

	KGJAT	KLART	VR20M	HTGJU	TMUSB	UVA20	UZZ20	GJLDD	GJLDM	GJGJD
KGJAT	1.00									
KLART	.64	1.00								
VR20M	-.74	-.59	1.00							
HTGJU	.62	.42	-.35	1.00						
TMUSB	.67	.43	-.48	.44	1.00					
UVA20	-.72	-.50	.66	-.56	-.54	1.00				
UZZ20	-.40	-.23	.31	-.26	-.32	.58	1.00			
GJLDD	.30	.12	-.34	.14	.41	-.45	-.43	1.00		
GJLDM	.14	.19	-.18	.07	.13	-.12	-.09	.21	1.00	
GJGJD	.17	.08	-.25	-.01	.12	-.24	-.26	.27	.16	1.00

Amza e lidhmërive lëvizore dhe situacionale është paraqitur në tabelën 5. Në këtë tabelë të gjitha ndryshoret lëvizore bazike kanë treguar lidhmëri të vlefshme ndërmjetvete. Kjo lidhmëri e këtyre ndryshoreve është pritur pasi që testet e aplikuara kanë vlerësuar aftësi fizike të cilat gjenerohen pothuajse nga i njëjti faktor.

Ndryshorja e udhëheqjes me top vajtje-ardhje varet në një masë të madhe nga shpejtësia e lëvizjes dhe kështu ky test ka treguar lidhmëri me testet lëvizore bazike.

Testet të cilat kanë matur saktësinë e gjuajtjeve kanë treguar lidhmëri me disa prej ndryshoreve tjera lëvizore. Ndryshorja e vetme e cila nuk ka treguar lidhmëri me asnjë ndryshore tjetër lëvizore është ajo e gjuajtjeve të lira me dorën e majtë.

Sqarim:

Çdo vlerë korelative më e madhe se **.25** është statistikisht e vlefshme në nivel të probabilitetit 0.05,

Tabela 6 - Lidhmëritë e ndryshoreve morfologjike, lëvizore bazike dhe situacionale

	KGJAT	KLART	VR20M	HTGJU	TMUSB	UVA20	UZZ20	GJLDD	GJLDM	GJGJD
LARTT	.61	.27	-.40	.72	.52	-.62	-.37	.13	.04	.16
PESHA	.25	.19	-.13	.61	.29	-.39	.01	.16	.20	-.09
GJAKRA	.43	.30	-.25	.67	.43	-.57	-.28	.21	.07	.10
GJAKEM	.26	.03	-.08	.35	.04	-.21	-.05	.04	-.07	.13
GJAPELL	.17	.10	-.05	.47	.15	-.31	-.21	.05	-.03	-.09
GJEPELL	-.11	-.12	.12	.18	.02	.02	.20	-.17	-.04	-.10
GJASHP	.24	.32	-.16	.46	.25	-.39	-.32	.19	.18	-.01
GJESHP	.03	-.11	.23	.38	.05	-.08	-.05	.00	-.09	-.11

Lidhmëritë ndërmjet dy hapësirave janë paraqitur në tabelën 6. Në këtë tabelë nuk kemi ndonjë variabël e cila ka pasur lidhmëri me të gjitha ndryshoret tjera.

Gjuajtjet në kosh ato të cilat vlerësojnë precizitetin nuk ka lidhmëri me asnjë nga masat morfologjike.

Lartësia e trupit dhe gjatësia e krahut kanë lidhmëri me të gjitha ndryshoret përpos atyre të precizitetit.

Gjuajtja e topit nga pozita e ulur poashtu ka realizuar lidhmëri të vlefshme me shumë ndryshore morfologjike.

Sqarim:

Çdo vlerë korelative më e madhe se **.25** është statistikiisht e vlefshme në nivel të probabilitetit 0.05,

5.3 Ndryshimet ndërmjet grupeve për ndryshoret morfologjike, lëvizore bazike dhe situacionale

Tabela 7 – Mesataret aritmetikore të ndryshoreve, t-testi (dallimi ndërmjet grupeve) dhe f-testi

	Mean 1	Mean 2	t-value	p	F-ratio	p
LARTT	175.23	176.70	-.56	.58	1.23	.59
PESHA	62.03	64.99	-1.09	.28	1.68	.17
GJAKRA	77.08	76.64	.36	.72	1.32	.46
GJAKEM	89.87	93.05	-.99	.33	4.75	.00
GJAPPELL	26.89	26.50	1.01	.31	1.13	.74
GJEPPELL	9.16	9.40	-.71	.48	4.01	.00
GJASHP	19.06	19.29	-.62	.54	1.08	.84
GJESHP	8.14	8.21	-.60	.55	1.02	.95
KGJAT	201.00	203.23	-.38	.70	1.16	.70
KLART	39.97	39.83	.08	.94	1.28	.51
VR20M	3.68	3.76	-.83	.41	1.49	.29
HTGJU	8.71	9.10	-1.00	.32	1.20	.63
TMUSB	21.20	21.37	-.25	.81	1.20	.63
UVA20	9.21	9.27	-.33	.74	1.01	.97
UZZ20	4.98	5.06	-.61	.54	1.18	.66
GJLDD	2.77	2.43	1.11	.27	1.51	.27
GJLDM	1.07	1.23	-.59	.56	1.07	.85
GJGJD	2.87	3.27	-1.28	.21	1.06	.88

Në tabelën 7 janë paraqitur mesataret aritmetike të dy grupeve të basketbollistëve si dhe ndryshimet ndërmjet këtyre grupeve në ndryshoret morfologjike, lëvizore dhe lëvizore situacionale.

Në të gjitha ndryshoret e këtij punimi nuk kemi pasur ndryshime statistikisht të vlefshme ndërmjet grupeve.

Të vetmin ndryshim ndërmjet grupeve për dy variabla e ka dhënë (F-ratio) raporti i variancës i cili nuk ka treguar dallime për ndryshoret gjatësia e këmbës dhe gjerësia e pëllëmbës.

5.4 Parashikimi i ndryshoreve kriterike

Tabela 8 - Regresioni i ndryshores kriterike **driblimi në formë zik-zake 20m** me sistemin prediktor të ndryshoreve morfologjike.

R	R Square	Adjusted R	Error	F	Q
.57	.32	.22	.46	3.02	.01

	Corel	Partial Cor.	Beta	Std.Err. of Beta	Q Beta
LARTT	-.37	-.32	-.45	.18	.02
PESHA	.01	.20	.22	.16	.16
GJAKRA	-.28	-.01	-.01	.21	.97
GJAKEM	-.05	.05	.04	.12	.74
GJAPELL	-.21	.10	.15	.21	.49
GJEPELL	.20	.29	.30	.14	.03
GJASHP	-.32	-.30	-.39	.18	.03
GJESHP	-.05	-.01	-.01	.15	.95

I tërë sistemi prediktor i ndryshoreve morfologjike në raport me testin kriterik kanë treguar ndikim të vlefshëm në nivel $Q=.01$ të probabilitetit. Lidhmëria e shumëfishtë ka koeficient .57.

Në lidhmëri të vlefshme me kriterin janë ndryshoret e gjatësisë së krahut dhe shputës si dhe lartësia e trupit. Por kontributi parcial dhe beta koeficienti janë treguar statistikisht të vlefshëm vetëm për ndryshoret lartësia e trupit ($Q\text{ beta} =.02$), dhe gjatësia të shputës ($Q\text{ beta} =.03$). Pasi koeficienti parcial i korrelacionit të lartësisë dhe gjatësisë së shputës kanë parashenjën minus atëherë mund të kuptojmë se ky është një ndikim pozitiv i këtyre ndryshoreve në parashikimin e kriterit. Mirëpo, subjektet të cilët gjerësinë e pëllëmbës së dorës e kanë më të madhe, ata kanë treguar rezultat më të dobët në udhëheqjen e topit në formë zik-zake në 20m.

Tabela 9 - Regresioni i ndryshores kriterike **Driblimi në formë zik zake 20m** me sistemin prediktor të ndryshoreve lëvizore bazike dhe situacionale .

R	R Square	Adjusted R	Error	F	Q
.63	.40	.31	.43	4.24	.00

	Corel	Partial Cor.	Beta	Std.Err. of Beta	Q Beta
KGJAT	-.40	-.10	-.16	.23	.49
KLART	-.23	.01	.01	.15	.95
VR20M	.31	-.17	-.23	.18	.22
HTGJU	-.26	.10	.11	.15	.47
TMUSB	-.32	.04	.04	.15	.80
UVA20	.58	.43	.61	.18	.00
GJLDD	-.43	-.22	-.22	.13	.11
GJLDM	-.09	-.01	-.01	.11	.93

Të gjitha ndryshoret së bashku në raport me testin kriterik, kanë treguar ndikim të vlefshëm në parashikimin e driblimit në formë zik-zake 20m, kjo është paraqitur në tabelën 9.

Korrelacioni i shumëfishtë është në vlerat e rëndësishme statistikore .63, kurse ai i korigjuar (Adjusted R) edhe më i vogël. F-testi (4.24) me të cilin përcaktohet kufiri i vlefshmërisë statistikore të tërë sistemit është i rëndësishëm në nivel të probabilitetit (Q = .00).

Driblimi i topit në formë zik-zake 20m mund të parashikohet vetëm nga udhëheqja vajtje ardhje 20m. Vlerat e koeficientit të standardizuar të regresionit – Beta për këtë ndryshore janë .61, të cilat janë të vlefshme në nivel të probabilitetit .00.

Tabela 10 - Regresioni i ndryshores kriterike **Gjuajtje në kosh nga gjysmë distanca 3m** me sistemin prediktor të ndryshoreve morfologjike.

R	R Square	Adjusted R	Error	F	Q
.37	.13	.00	1.22	.98	.46

	Corel	Partial Cor.	Beta	Std.Err. of Beta	Q Beta
LARTT	.16	.18	.28	.21	.19
PESHA	-.09	-.18	-.23	.18	.20
GJAKRA	.10	.12	.22	.24	.37
GJAKEM	.13	.09	.09	.14	.51
GJAPPELL	-.09	-.22	-.39	.24	.11
GJEPPELL	-.10	-.01	-.01	.15	.97
GJASHP	-.01	.08	.11	.20	.57
GJESHP	-.11	-.01	-.02	.16	.92

Në tabelën 10 është paraqitur regresioni i variablës kriterike gjuajtje në kosh nga gjysmë distanca 3m me sistemin e ndryshoreve morfologjike.

Korelacioni i shumëfishtë nuk ka treguar lidhmëri me sistemin e variablës kriterike vlera e tij është .37 e që nuk e kalon pragun e probabilitetit të vlefshmërisë statistike 0.05

Në këtë tabelë në raport me testin kriterik nuk është realizuar asnjë lidhmëri e vlefshme.

Tabela 11 - Regresioni i ndryshores kriterike **Gjuajtje në kosh nga gjysmë distanca 3m** me sistemin prediktor të ndryshoreve lëvizore bazike dhe situacionale .

R	R Square	Adjusted R	Error	F	Q
.39	.15	.00	1.22	.99	.46

	Corel	Partial Cor.	Beta	Std.Err. of Beta	Q Beta
KGJAT	.17	.04	.07	.28	.80
KLART	.08	-.07	-.09	.18	.63
VR20M	-.25	-.10	-.16	.22	.47
HTGJU	-.01	-.13	-.17	.18	.36
TMUSB	.12	-.04	-.06	.18	.75
UVA20	-.24	-.06	-.10	.24	.67
GJLDD	.27	.11	.12	.16	.46
GJLDM	.16	.11	.11	.14	.43

Sistemi i ndryshoreve motorike nuk kanë ndikim në parashikimin e gjuajtjes në kosh nga gjysmë distanca 3m, kjo është paraqitur në tabelën 11 të regresionit.

Lidhmëritë e thjeshta të ndryshoreve vrapim 20 metra dhe gjuajtje të lira me dorën e djathtë kanë treguar lidhmëri të vlefshme statistikore, por pas eliminimit të ndikimit të varablave tjera në sistem kjo lidhmëri nuk është përcjellë edhe në lidhmëritë parciais dhe beta koeficientin.

Gjuajtjet në kosh nga gjysmë distanca 3m nuk mund të parashikohet me asnjë variabël veç e veç të sistemit motorik të aplikuar në këtë punim. Një shpjegim i mundshëm për këtë dukuri mund të jepet sepse saktësia është aftësi e ndjeshme lëvizore.

5.5 Vërtetimi i hipotezave të parashtruara

Më qëllim të vërtetimit të saktë dhe shkencore të temës së parashtruar dhe objektivave primare të këtij punimi do të bëhet edhe vërtetimi apo hedhja poshtë e hipotezave të parashtruara më parë:

Hipoteza e parë e këtij punimi nuk është vërtetuar për shkak se nuk kemi pasur ndryshime statistikisht të vlefshme ndërmjet grupave në ndryshoret e parashtruara në këtë punim dhe si e tillë kjo hipotezë nuk mund të vërtetohet.

Hipoteza e dytë është vërtetuar dhe si e tillë mund të pranohet sepse tek shumica e ndryshoreve kemi pasur shpërndarje normale të rezultateve.

Hipoteza e tretë e parashtruar është vërtetuar pjesërisht pasi që sistemi i ndryshoreve lëvizore tek varaibala kriterike driblimi në formë zik zake 20m është treguar i vlefshëm në parashikimin e kriterit, ndërsa tek variabla gjuajtje nga gjysmëdistanca nuk ka treguar ndikim të vlefshëm në parashikimin e kriterit.

6. PËRFUNDIMI

Ky punim ka përfshirë në vete mostrën e entiteteve nga 60 basketbollistë aktiv (meshkuj) të moshës 14-15 vjeçarë të ndarë në dy grupe në bazë të shkollave ku ushtrojnë.

Në këtë punim është trajtuar hapësira morfologjike me 8 ndryshore, lëvizore bazike me 5 ndryshore dhe lëvizore situacionale me 5,

Shumica e ndryshoreve të këtij punimi kanë pasur shpërndarje ka qenë në kufi të normales përveç disa ndryshoreve situacionale të preciziteti të cilat nuk kanë pasur shpërndarje normale.

Me anë të korelacionit kemi marrë informatë për lidhmëritë e ndryshoreve ndërmjet vete. Një dukuri që është vërejtur te lidhmëritë morfologjike është se gjatësia e këmbës dhe gjerësia e pëllëmbës së dorës kanë realizuar më pak lidhmëri me variaiblat e tjera morfologjike.

Lidhmëria e hapësirës lëvizore bazike ka qenë më e madhe me ndryshoret e tjera bazike, ndërsa me ato situacionale kemi një lidhmëri më të vogël ndërmjet vete.

Lidhmëritë ndërmjet hapësirave të hulumtuara kanë qenë jo aq të shprehura. Ndryshoret morfologjike të cilat kanë realizuar lidhmëri të vlefshme me testet lëvizore bazike janë lartësia e trupit dhe gjatësia e krahut.

Me anë të T-testit janë vërejtur dallimet ndërmjet dy grupeve për ndryshoret morfologjike, lëvizore dhe lëvizore situacionale. Grupet nuk kanë treguar madje asnjë ndryshim statistikisht të vlefshëm ndërmjet vete në ndryshoret e aplikuara në këtë punim.

Me analizën regresive është vërejtur ndikimi i sistemi të ndryshoreve predikatore në ndryshoret kriterike. Driblimi i topit në formë zik zake 20m mund të parashikohet nga sistemi i ndryshoreve morfologjike ku kontributin më të madhe kanë dhënë lartësia e trupit, gjerësia e shuplakës dhe gjatësia e shputës. Kriteri driblimi i topit në formë zik zake 20m është parashikuar në

mënyrë të vlefshme edhe nga sistemi i ndryshoreve lëvizore, ndërsa testet të cila kanë dhënë kontribut më të madh ka qenë udhëheqja e topit vajtje ardhje.

Variabla e gjuajtjeve të precizitetit nga distanca nuk mund të parashikohet as me sistemin e ndryshoreve morfologjike as me sistemin e ndryshoreve lëvizore.

Duke pasur parasysh ndikimin e statusit morfologjik dhe aftësive lëvizore në basketboll ne mund të konkludojmë se ky punim është i arsyeshëm dhe i pranueshëm për hulumtim nga ana jonë si student të shkencave sportive.

Pra, duke pasur parasysh që basketbolli është një sport i cili kërkon përgatitje të lartë fizike, ne duhet të jemi të vetëdijshëm se për tu marrur me këtë sport duhet të kemi kujdes dhe qasje të veçantë ndaj këtij sporti.

Puna me kategoritë e pionierëve në shkollën e basketbollit ka vendin e vet në zhvillimin e sportistit. Kjo është puna e parë fillestare, sistematike dhe planifikimi me sportistët e rinj. Andaj puna me këto kategori duhet t'i besohet pedagogëve të vërtetë dhe mjeshtërve të dalluar të basketbollit.

Në bazë të rezultateve të arritura në këtë punim nuk mund të arrijmë në një përfundim të qartë në lidhje me temën e parashtruar sepse një ndër faktorët të cilët ka mund të ndikoj drejtpërdrejtë në rezultate është edhe mosha e pubertetit të mostrës së hulumtuar.

Mund të themi se ne nuk do të mbetemi të kufizuar por gjithnjë e më shumë do të bëjmë përpjekje që sporti i basketbollit të jetë një sport i cili do tu shërbej të gjithë atyre që dëshirojnë të merren me basketboll.

Ne shpresojmë që ky punim do tu dal në ndihmë të gjithë studentëve të shkencave sportive, pedagogëve të edukimit fizik dhe të gjithë atyre që dëshirojnë të merren me sportin e basketbollit.

6. CONCLUSION

This work has involved entities sample of 60 active basketball players (male) aged 14-15 years, divided into two groups based on the schools where they exercise.

In this paper was treated morphological space with 8 variables, basic motoric with 5 and situational with 5 variables,

Most of the variables of this study have normal distribution except some situational variables of precision which did not have a normal distribution.

Through correlation we get information about relations among variables themselves. A phenomenon that has been observed is that the relations of morphological foot length and width of the palm have realized less correlation with other morphological variables.

Relations between basic motor space has been great with other basic variables, while those situational have a smaller coherence among themselves.

Correlation among the surveyed areas were not expressed so. Morphological variables that have performed valuable conjunction with basic motoric tests are the body height and wing length.

Through T-test were observed differences between the two groups for morphological, motoric and situational variables. Groups did not show even a statistically valid difference between variables applied in this paper.

With regression analysis was observed impact of system predictive variables in the criteria variables. Dribble the ball in physical slalom form 20m can be predicted by the morphological variables system where greater contribution given body height, width and length of the plantar. Criteria dribble the ball in physical form slalom 20m is set so valid form motoric system of variables, and tests of which have contributed to greater has been in the dribble the ball shuttle.

Variable precision shooting distance can not be predicted with morphological system of variables or with variable motoric system.

Given the impact of morphological status and motoric skills in basketball we can conclude that this paper is reasonable and acceptable for research by our sports science student.

Given that basketball is a sport that requires high physical preparation, we must be aware that to deal with this sport we must be careful and particular approach to the sport.

Working with youth categories in the basketball school has its place in the development of sportsman. This is the first in beginning work, systematic and planning with young athletes. So, work with these categories should be trusted real teachers and distinguished masters of basketball.

Based on the results obtained in this paper we can not reach a clear conclusion about the topic submitted because one of the factors that could directly affect the results is the age of puberty in the researched sample.

We can say that we will not remain limited but increasingly will make efforts in sport of basketball to be a sport which will serve all those who wish to deal with basketball.

We hope that this paper will be on help to all students of sports science, physical education teachers and all those who wish to deal with the sport of basketball.

7. BIBLIOGRAFIA

- Colman, B , (Ray ,P Basketbal technichues)
- Çitaku, F. (1984): Relacionet e ca dimensioneve motorike në grup sportistësh në tri disiplina sportive. Elan, nr. 11, Prishtinë.
- Dokman. T. (2005) ndryshimet ndërmjet dy gjeneratave të basketbollistëve Kroate në treguesit e përgatitjes kondicionale, kondicijski trening Zagreb.
- Gjinolli, E. (1997): Karakteristikat morfologjike dhe motorike të vlefshme për volejball te nxënësit e klasës së pestë të shkollës fillore. Disertacion doktore. Prishtinë,
- Kline, L. (2005): Five Stars Basketball,
- Nixha, M. (1982): Analiza kooperative e karakteristikave trupore dhe aftësive motorike të basketbollistëve të niveleve të ndryshme garuese.
- Nixha, M. (1985): Analiza e karakteristikave trupore dhe aftësive motorike të basketbollistëve të niveleve të ndryshme të garave dhe analiza komparative me volejballistë dhe hendbollistë. Disertacion doktore, Beograd.
- Nixha, M. (2004): Basketbolli , Bazat themelore të basketbollit. Prishtinë.
- Rexha A—Punim diplome Rëndësia dhe karakteristikat të lojes se basketbollit
- Salihu H. (2003): Ndryshimet e zhvillimit te veçorive morfologjike dhe aftësive lëvizore tek basketbollistët e rinj. Disert Doc Tiranë
- Salihu H. (2004): Analizë e shkurtër lidhur me basketbollin bashkëkohorë Studime Sportive nr.4. Tiranë.
- Salihu, H. (2004): “Ndryshimet e zhvillimit të veçorive morfologjike dhe aftësive lëvizore tek basketbollistët e rinjë të moshës 16 vjeç + 6 muaj
- Shalci, Q. (1994): Mbi disa probleme të vështuara komplekse për përgatitjen e basketbollistëve (të rritur), në përshtatje me kërkesat e kohës.
- Sharti, F. (2006), Ndryshimet e disa parametrave morfologjik dhe testeve motorike bazike dhe situacionale ndërmjet basketbollistëve të Superligës dhe ligës së parë të Kosovës, Punim maxhistrature.
- Stronger team 2009 basketball specific strength & Conditioning

P Ë R M B A J T J A

1. HYRJE	2
2. HULUMTIMET E DERITANISHME	3
3. QËLLIMI I PUNIMIT	6
3.1 Hipotezat themelore	7
4. METODOLOGJIA E PUNËS.....	7
4.1 Mostra e entiteteve.....	7
4.2 Mostra e ndryshoreve të testeve	7
4.3 Përshkrimi i instrumenteve matëse të përdorura.....	9
4.4 Mënyra e zbatimit të procesit matës	10
4.5 Përshkrimi i ndryshoreve matëse të punimit.....	11
4.5.1 Ndryshoret Morfologjike.....	11
4.5.2 Ndryshoret Motorike	15
4.6 Metodat e përpunimit të rezultateve	25
5. REZULTATET DHE DISKUTIMI.....	26
5.1 Parametrat themelor statistikor të ndryshoreve morfologjike, lëvizore bazike dhe situacionale	26
5.2 Lidhmëritë ndërmjet ndryshoreve morfologjike, lëvizore bazike dhe situacionale	38
5.3 Ndryshimet ndërmjet grupeve për ndryshoret morfologjike, lëvizore bazike dhe situacionale	41
5.4 Parashikimi i ndryshoreve kriterike.....	42
5.5 Vërtetimi i hipotezave të parashtruara.....	46
6. PËRFUNDIMI.....	47
7. BIBLIOGRAFIA	51